

**KONFERENCË NDËRKOMBËTARE**  
**“NDARJA DHE BALANCIMI I PUSHTETEVE – ROLI I KONTROLLIT**  
**KUSHTETUES”**  
**TIRANË, 7 – 8 QERSHOR 2012**

*Fjala Hyrëse e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Z.Bashkim DEDJA*

**I nderuar Zoti President i Republikës,**

**Të nderuar kryetarë dhe anëtarë të Gjykatave Kushtetuese,**

**Të nderuar pjesëmarrës,**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë mbush 20 – vjet veprimtari që nga krijimi i saj në vitin 1992. Është nder dhe kënaqësi që jeni me ne për ta kujtuar së bashku këtë përvjetor dhe për të shkëmbyer eksperiencat më të mira kushtetuese në drejtim të respektimit të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve si tema e kësaj konference ndërkombëtare. Në emër të Gjykatës Kushtetuese ju falënderoj përzemërsisht për praninë Tuaj në këtë ngjarje. Falënderojmë në mënyrë të posaçme për praninë e tyre, gjithashtu dhe Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut z.Nicolas Bratza si dhe Presidentin e Komisionit të Venecias z.Gianni Buquicchio.

Gjykata Kushtetuese Shqiptare u krijua si pasojë e proceseve demokratike në vend, pas viteve 90'. Në vendet e Evropës Lindore përfshirë dhe Shqipërinë, procesi i demokratizimit ka pasur luhatjet e veta, dhe krijimi i një institucioni si Gjykata Kushtetuese ka luajtur një rol aktiv në këtë proces. Veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese mund të ndahet në dy etapa. Në etapën e parë 1992-1998 veprimtaria e saj është mbështetur në Dispozitat Kryesore Kushtetuese. Në këtë etapë edhe pse pa përvojën e duhur, kjo Gjykatë arriti të vendosë gurët e parë të themelit të një praktike kushtetuese, që u konsolidua më pas në etapën e dytë pas vitit 1998, me miratimin e Kushtetutës.

Kushtetuta jonë sanksionon vlera demokratike të gjithëpranuara nga vendet evropiane perëndimore dhe demokracitë përparimtare, përgjithësisht siç ndodh me Kushtetutat e reja në moshë, por në praktikë situata është më e komplikuar. Kjo varet nga kultura politike, juridike, stadi ekonomik dhe shoqëror e të tjerë faktorë të një vendi të caktuar. Këta faktorë shpjegojnë dhe diferencat mes vendeve me demokraci të konsoliduar nga vendet me demokraci në zhvillim, edhe pse në nivelin juridiko-formal mund të jenë palë e të njëjtave konventa dhe akteve

ndërkombëtare. Në këtë kontekst, mund të kuptohet dhe sfida e Gjykatës Kushtetuese si promotore e realizimit të drejtësisë kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese ndër vite është përpjekur t'i interpretojë normat kushtetuese, me synim dhënien e kuptimit më të mirë të mundshëm dhe efikas, sipas përjasjes se: “ *...Kushtetuta duhet interpretuar si një “instrument i gjallë”, nën dritën e kushteve aktuale jetësore dhe, në mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe më efikas të mundshëm*” **1[1]** .

Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës si akti më i lartë në hierarkinë e normave juridike. Ish- Presidenti Francez Sarkozy ka theksuar në 50 vjetorin e Këshillit Kushtetues Francez: “*Të gjithë skeptikëve të hierarkisë së normave, të gjithë atyre që shpërfillin kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve, dua t’ju kujtoj se nuk është aq e largët dita kur gjysma e Evropës jetonte nën zgjedhën e një ideologjie që përçmonte të drejtat më themelore të individit. Nuk është aq e largët koha kur pranë dyerve tona popuj të tërë privoheshin nga këto liri thelbësore të shenjtëruara në Francë që nga viti 1789, liria e ndërgjegjes dhe e besimit fetar, liria e shprehjes, liria e lëvizjes, mbrojtja kundër burgimit arbitrar, pa të cilat jeta nuk është gjë tjetër veçse frikë*” **1[2]** .

Misioni i Gjykatës Kushtetuese është zëbrthimi i parimeve të shtetit të së drejtës, konturimi i sjelljes së autoriteteve publike brenda këtyre parimeve si domosdoshmëri për parandalimin e abuzimit me pushtetin, kontrolli i parimit të ndarjes së pushteteve, kontrolli i respektimit të të drejtave të njeriut dhe si një emërues të përbashkët i këtij misioni, forcimi i demokracisë kushtetuese në vend, ku duhet të prevalojë përparësia e Kushtetutës.

**Shteti i së drejtës** është një parim themelor kushtetues, i konceptuar si kolona e sistemit kushtetues. Kushtetuta mund të cenohet nga ligje që bien në kundërshtim me dispozitat e saj, por ajo mund të cenohet edhe në frymën, dhe vlerat themelore që ajo shpreh dhe mbron. Sipas Gjykatës Kushtetuese, parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe nënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike **1[3]** . Shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit apo të personave

---

juridikë, duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë shqyrtimit të procesit <sup>1[4]</sup> . Parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike me të larta, si në kuptimin formal, ashtu dhe në atë material <sup>1[5]</sup> . Shteti i së drejtës, i cili garantohet që në Preambulën e Kushtetutës, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, ai përbën një normë të pavarur kushtetuese, prandaj shkelja e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues <sup>1[6]</sup> .

**Ndarja e pushteteve** , e njohur gjithashtu si *trias politica*, është një model i qeverisjes së shteteve demokratike. Në demokraci , parimi i rëndësishëm i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve synon kryesisht të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi apo të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij. Për këtë qëllim, pavarësisht se pushteti shtetëror në tërësi është një dhe i pandarë, brenda tij ka një sërë ndërthurjesh dhe raportesh të ndërsjella që Kushtetuta krijon ndërmjet segmenteve të caktuara të tij. Në lidhje me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, Gjykata Kushtetuese me jurisprudencën e saj i ka dhënë jetë normave kushtetuese ku është sanksionuar ky parim <sup>1[7]</sup> dhe normave kushtetuese ku është sanksionuar juridiksioni i Gjykatës mbi mosmarrëveshjen e kompetencave mes pushteteve <sup>1[8]</sup> . Gjykata Kushtetuese e ka parë këtë parim jo vetëm në aspektin e ndarjes dhe balancimit të tre (3) pushteteve klasike, por edhe në kuadrin e mosndërhyrjes apo qartësimit të kompetencave edhe të organeve të pavarura kushtetuese që nuk bëjnë pjesë në asnjë nga pushtetet, por që kanë elementë të këtyre pushteteve, si Presidenti, Prokurori i Përgjithshëm apo Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Gjykata Kushtetuese ka shkuar më tej, duke interpretuar si konflikt mes pushteteve edhe konfliktin kushtetues mes pakicës parlamentare

---

dhe Kuvendit si organ i pushtetit legjislativ. Sipas kësaj gjykate, çdo organ juridiksional, në kuptimin klasik administrativ të tij, si dhe çdo subjekt që ushtron funksionet në një situatë pavarësie të plotë të garantuar nga Kushtetuta, konsiderohet i legjitimuar për të qenë palë në një mosmarrëveshje pushtetesh para Gjykatës Kushtetuese. Kjo gjykatë, duke mbajtur parasysh dhe standardet ndërkombëtare në këtë drejtim, i ka kushtuar me të drejtë vëmendje të veçantë *pushtetit gjyqësor* krahasuar me dy pushtetet e tjera, si dhe *pakicave parlamentare dhe organeve të tjera të pavarura* që nuk bëjnë pjesë në asnjë nga tri pushtetet.

Kushtetuta Shqiptare **të drejtat dhe liritë themelore të njeriut** i ka huazuar thuajse në mënyrë identike nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, madje këtë të fundit, e ka vënë në një nivel me Kushtetutën, për sa i përket kufizimeve që mund t'i bëhen të drejtave dhe lirive 1[9] . Në një numër të madh vendimesh Gjykata Kushtetuese ka interpretuar standardet kushtetuese lidhur me kufizimin e të drejtave; si kufizimin vetëm me ligj të miratuar nga Kuvendi; 1[10] kufizimin për interes publik ose për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve; 1[11] respektimin e parimit të proporcionalitetit 1[12] ; mosdhunim i thelbit të së drejtës dhe për çdo rast jo tejkalim të kufizimeve të sanksionuara në KEDNJ 1[13] . Sipas Gjykatës Kushtetuese, s'anksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar në Kushtetutë dhe shoqërimi me masat për vënien e tyre në jetë duhet të synojnë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave 1[14] .

Një pjesë e konsiderueshme e veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese është e lidhur me kontrollin e procesit të rregullt ligjor, e drejtë procedurale kushtetuese. Kjo gjykatë ndër vite e ka zgjeruar konceptin e të drejtave të individit dhe së drejtës së tij për t'u ankuar në përputhje me standardet e GJEDNJ-së. Sipas jurisprudencës tashmë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës nuk është

---

e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ, parlamentar 1[15]. Gjithashtu Gjykata Kushtetuese ka zgjeruar hapësirat e individit, duke e interpretuar legjitimimin maksimalisht në favor të aksesit në gjykatë. Individit mund t'i drejtohet kësaj gjykate jo vetëm kur ka ezauruar të gjitha shkallët e gjykimit, por edhe kur ndjekja e procedurave të ankimit do të rezultonte me tejzgjatje të shkeljes ose një rëndim të mëtejshëm të situatës. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se mund të merren në shqyrtim nga kjo gjykatë edhe kërkesat e individëve, për cenimin e të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të tyre mund të mos ketë përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm 1[16]. Po kështu kjo gjykatë ka pranuar se kur kërkuesi i ka shteruar mjetet e ankimit, dhe kur karakteri i vendimit të ndërmjetëm e kërkon, si përjashtim, ai mund të konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131/f të Kushtetutës, duke i hapur rrugë kontrollit kushtetues të kësaj kategorie vendimesh 1[17].

Në raport me efektin e vendimeve të GJEDNJ në sistemin e brendshëm ligjor shqiptar, kjo Gjykatë, në një çështje risi, ka shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Lartë me arsyetimin, se edhe pse sistemi penal shqiptar nuk lejon (nga pikëpamja formale) një rishikim të vendimeve penale përfundimtare nëpërmjet rihapjes së procesit, pas konstatimit nga GJEDNJ të shkeljeve serioze të procesit të drejtë, Gjykata e Lartë duhet të zbatojë drejtpërsëdrejti Kushtetutën dhe KEDNJ-në, duke rihapur proceset penale të përfunduara me vendim të formës së prerë, pas dhënies së një vendimi nga GJEDNJ 1[18].

Gjithsesi të drejtat e njeriut janë axhendë globale. Çdo diskutim mbi sfidat e të drejtave të njeriut në shekullin e 21-të do të ishte kuptimplotë vetëm si pjesë e proceseve historike, ku kërkesat e një shoqërie për liri dhe prosperitet kanë mbetur dëshira të pareaizuara dhe detyra gjysmë të plotësuara, edhe pse, të gjitha shoqëritë vazhdojnë të jenë në përpjekje të vazhdueshme për të përkufizuar dhe ripërkufizuar konceptin e të drejtave dhe lirive si dhe për të gjetur apo përmirësuar mekanizmat mbrojtës të tyre.

---

\*\*\*

Gjykata Kushtetuese ka përgjegjësinë për të shqyrtuar dhe për të marrë përsipër rrisqe për t'iu përgjigjur problemeve që u shtrohen demokracive të reja, për t'iu përgjigjur interesave madhore, në një rrafsh shumë më të gjerë se ai kombëtar dhe për të shmangur apo ulur tensione të ndryshme sociale apo politike. Në këtë kontekst një vendim unik i kësaj gjykate ka qenë e ashtuquajtura “Marrëveshje e Detit”, ku njëzëri prej saj u vendos papajtueshmëria me Kushtetutën e Shqipërisë e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë “Për delimitimin e zonave të tyre përkatëse të shelfit kontinental dhe zonave të tjera detare që u përkasin në bazë të së drejtës ndërkombëtare”, për shkak se binte ndesh me tërësinë territoriale të shtetit Shqiptar, si dhe me ndarjen dhe ekuilibrimin e pushteteve <sup>1</sup>[19] . Po ashtu një vendim mjaft i vlerësuar <sup>1</sup>[20] i kësaj gjykate ka qenë shfuqizimi i të ashtuquajturit “ligji i Lustracionit”, me anë të të cilit u vendos se ligji “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve”, binte ndesh me parimet kushtetuese, si pavarësinë e organeve kushtetuese, ndarjen e pushteteve, hierarkinë e normave juridike, proporcionalitetin në kufizimin e të drejtave themelore të njeriut. <sup>1</sup>[21]

Duke pasur parasysh se zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ndikon në rritjen e autoritetit të saj, ajo i ka dhënë rëndësi dhe **efekteve të vendimmarrjes** së saj, duke theksuar se vendimet e gjykatës janë të detyrueshme mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike dhe gjykatat. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit . I detyrueshëm nuk është vetëm dispozitivi i vendimeve të Gjykatës, por edhe pjesa arsyetuese e vendimit. Megjithatë në disa raste vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk janë respektuar nga organet shtetërore <sup>1</sup>[22] . Kështu në një çështje të shqyrtuar nga Gjykata, edhe pse disa nene të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës u shfuqizuan për papajtueshmëri me Kushtetutën, Kuvendi në plotësim të boshllëkut ligjor të krijuar, miratoi në substancë po të

---

njëjtat dispozita, duke mos mbajtur parasysh vendimin e mëparshëm të kësaj gjykate, dispozita që përsëri u shfuqizuan nga Gjykata Kushtetuese 1[23].

\*\*\*

Përtej arritjeve, duhet pranuar që në disa raste kjo gjykatë është gjendur dhe në vështirësi dhe kjo ka ndodhur kur politika e nxehtë e ditës e ka vendosur Gjykatën Kushtetuese në qendër të debatit, si p.sh. polemikat mbi rotacionin dhe përbërjen e GJK-së, e cila ndodhej para faktit të ripërtëritje me 2/3 e saj. Kjo gjykatë *de jure* u vu në lëvizje nga një grup deputetësh për interpretim të normës kushtetuese, ku sanksionohej se Gjykata Kushtetuese duhej të ripërtërihej me 1/3 e saj. GJK u shpreh mbi ruajtjen në përbërje të Gjykatës Kushtetuese të një shumice prej dy të tretave të anëtarëve në detyrë, duke bërë të mundur krijimin e një përvoje juridike të posaçme në fushën e gjykimit kushtetues. Sipas GJK gjetja dhe zbatimi i një mekanizmi të përshtatshëm, për të respektuar Kushtetutën, mbi rotacionin e anëtarëve të gjykatës me 1/3 e saj ishte kompetencë e ligjvënësit kushtetues 1[24].

Megjithatë është fakt që ky 20 vjetor e ka gjetur Gjykatën Kushtetuese të paplotë në anëtarësinë e saj. Edhe në Progres- Raportin e Komisionit Evropian 2011, është theksuar se: *“Kuvendi akoma nuk ka zhvilluar procesin e emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, i cili përbën element kyç dhe në 12 rekomandimet e Opinionit të Komisionit Evropian për Shqipërinë pas aplikimit për marrjen e statusit kandidat, Nëntor 2010 ”* 1[25]. Po sipas këtij Komisioni, *“..procesi i emërimit mbetet një çështje shqetësuese në drejtim të zgjatjes së procesit dhe rrezikut të politizimit”* 1[26].

Pas gati 12 vjetësh nga zbatimi i ligjit organik, Gjykata Kushtetuese përballet dhe me sfida që i vijnë për shkak të nevojës për përmirësim të tij. Në lidhje me organizimin, ligji i mungojnë afatet e fillimit të procedurës së rekrutimit të gjyqtarëve kushtetues, dhe të emërimit të gjyqtarit të ri, para përfundimit të mandatit të rregullt të gjyqtarit paraprak. Ligji i mungon dhe përcaktimi i një mekanizmi mbi mënyrën e rekrutimit të kandidaturave para Presidentit, bazuar

---

mbi standardet e transparencës, meritokracisë, mosdiskriminimit. Ligji ka mangësi edhe në mungesën e parashikimit të së drejtës së GJK-së, që në rast konstatimi të shkeljes së të drejtave kushtetuese të vendosë dëmshpërblim për individin. Kërkesat para Gjykatës Kushtetuese lidhur me mosgjykimin brenda një afati të arsyeshëm dhe për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, janë shtuar në numër . Sipas GJEDNJ-së, Gjykata lidhur me këto dy elementë të pro cesit ligjor nuk është efektive, prandaj dhe riparimi i shkeljes nëpërmjet kompensimi të dëmit individit do të ndihmonte dukshëm në eliminimin apo shmangien e rasteve të përsëritura në praktikën e vendit tonë para GJEDNJ-së.

Rishikimi i ligjit, jo vetëm në elementët e sipërpërmendur, por edhe në heqjen e kufizimit ligjor që ekziston për disa subjekte që legjitimohen për nisjen e një gjykimi kushtetues, plotësimin e boshllëkut ligjor për procedura të veçanta kushtetuese, plotësimin e efekteve të hollësishme të vendimeve të gjykatës në varësi të llojit të vendimit, do të ishte i domosdoshëm.

Problematike për Gjykatën Kushtetuese ka qenë dhe mungesa e hapësirave infrastrukturore si ambiente komode pune apo mangësi financiare <sup>1</sup>[27] për t'iu përshtatur teknologjisë bashkëkohore të kërkimit shkencor, me qëllim funksionimin efektiv dhe cilësor të saj si dhe rritjes së transparencës ndaj publikut. Prandaj dhe duhet të jetë në vëmendje të ligjvënësit mundësia për t'i garantuar Gjykatës Kushtetuese mbështetjen e nevojshme dhe mundësi të mëtjshme për cilësi dhe profesionalizëm në vendimmarrjen e saj, për sa kohë që qëllimi i përveçëm i çdo organi që i përket pushteteve të ndryshme është forcimi i demokracisë në interes të vendit.

### **Të nderuar Zonja dhe zotërinj!**

Në gjykimin tim, si Kryetar i Gjykatës Kushtetuese, pa hezitim mund të them se vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë dhënë një kontribut të çmuar në respektimin e parimeve, garancive si dhe mbrojtjen e vlerave kushtetuese. Në Raportin Analitik të Komisionit Evropian <sup>1</sup>[28] është theksuar se: “ *Gjykata Kushtetuese ka demonstruar pavarësi në rritje që nga viti 2005. Në një sërë çështjesh, ajo ka shfuqizuar apo pezulluar ligje të miratuara. Gjatë periudhës 2007-2010, 33 ligje kanë qenë objekte të kontrollit kushtetues: prej tyre 18 janë gjetur pjesërisht*

---



*antikushtetues, 2 plotësisht antikushtetues dhe në 13 raste Gjykata rrëzoi kërkesat për antikushtetutshmëri”.*

Sot, pas 20 vjetësh ne mund të eidentojmë se Gjykata Kushtetuese paraqitet në sytë e opinionit publik shqiptar me jurisprudencë të qëndrueshme dhe të pasur. Për t’ia arritur këtij qëllimi, ajo në vazhdimësi është përpjekur të ketë udhërrëfyese standardet kushtetuese të gjykatave simotra evropiane, më të vjetra në fushën e kontrollit kushtetues dhe sidomos standardet e GJEDNJ-së në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut.

Gjithsesi vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk ngrihen në boshllëk dhe jashtë konteksteve historike dhe politike të vendit. Sigurisht që zhvillimi i jurisprudencës kushtetuese mund të lëvizë edhe me ndryshimin e përbërjes së trupës gjyqësore. Detyrë e çdo gjyqtari kushtetues është që nëpërmjet vendimeve të tij, të bindë shoqërinë se vendimet e Gjykatës Kushtetuese qëndrojnë larg konsideratave politike dhe bazohen në standardet dhe vlerat kushtetuese.

Megjithatë jo të gjithë mund të jenë të kënaqur me vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Sidomos politika, e cila konfliktet brenda vetes i shndërron në konflikte juridike duke i paraqitur pra Gjykatës. Sigurisht Kushtetuta nuk është vetëm akti më i lartë në hierarkinë e normave por është dhe një dokumente politik, i cili reflekton zgjidhje dhe zgjedhje dhe për politikën. Në këtë kontekst çështjet e natyrës kushtetuese ballafaqohen apo ndërthuren dhe me çështje të natyrës politike. Madje edhe kur çështja nuk është e natyrës politike përsëri politizohet duke u përdorur vendimmarrja e kësaj gjykate si argument nga forcat politike kundërshtare për të provuar sukseset apo dështimet e tyre. Në gjykim zakonisht janë dy palë, rrallëherë e drejta u përket të dyve, kështu që njëra palë do humbasë dhe tjetra do fitojë. Pala humbëse do mbetet e pakënaqur dhe do përdorë shumë arsye për të argumentuar humbjen, duke e lidhur me gjykatën si të njëanshme, joprofesionale, të ndikuar politikisht, etj. Nuk është detyrë e gjykatës të kënaqë palët, detyrë e saj është të japë drejtësi. E rëndësishme për gjykatën është që ajo palë që fiton të fitojë me të drejtë dhe ajo palë që humbet, të humbasë me të drejtë. Vetëm duke gjykuar në këtë mënyrë, vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese fiton respektin e shoqërisë për vlerat kushtetuese që mbart, dhe sigurisht që dhe autoriteti i saj konsolidohet çdo ditë e më shumë.

Gjithsesi nuk ka demokraci funksionale aty ku nuk ka përplasje opinionesh dhe debate me forcën e argumenteve të arsyeshme dhe ligjore. Pa dyshim si ç do sistem i drejtësisë kushtetuese, edhe Gjykata Kushtetuese është e hapur për reflektime. K emi rrugë për të bërë, me

qëllim arritjen e një demokracie funksionale në përputhje me shtetin e së drejtës dhe për këtë jemi të ndërgjegjshëm, pavarësisht progresit të arritur deri tani. Vërtet Gjykata Kushtetuese është konsideruar si rojë e Kushtetutës, por federalisti Xhejms Madison ka theksuar se:

***“Përparimi dhe përhapja e njohurive është rojtari i vetëm i lirisë së vërtetë”.***

Së fundmi, më lejoni të shpreh mirënjohjen time për të gjithë ata që kanë dhënë ndihmesën e tyre në ngritjen, strukturimin e funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, që nga gjyqtarët e parë të saj, kryetarët e Gjykatës ndër vite, deri tek stafi mbështetës, për përpjekjet e vazhdueshme në rritjen cilësore të vendimmarrjes së kësaj gjykate, duke qenë të ndërgjegjshëm më së miri për rolin dhe funksionin e tyre.

Duke i uruar kësaj konference *punë të mbarë*, fjalën e ka Sh.T.Z. Bamir Topi...

*Ju falemnderit!*

---

1[1] Vendimi nr.26/2007

2[2] Konferencë e mbajtur me 3 Nëntor 2008;Paris-Francë

3[3] Vendimi nr.17/2005; Vendimi nr.11/2007; Vendimi nr.18/2008

4[4] Vendimi nr.43/2011

5[5] Vendimi nr.9/2010

6[6] Vendimi nr.9/2007

7[7] Neni 7

8[8] Neni 131/ç

9[9] Neni 17/2

10[10] Vendimi nr.20/2006

---

- 11[11] Vendimi nr.30/2005  
12[12] Vendimi nr.16/2004  
13[13] Vendimi nr.65/1999  
14[14] Vendimi nr.43/2011  
15[15] Vendimi nr.24/2007  
16[16] Vendimi nr.12/2012  
17[17] Vendimi nr.28/2011  
18[18] Vendimi nr.20/2011  
19[19] Vendimi nr.15/2010  
20[20] Dokumenti (COM(2010) 680), në pjesën “B” (kriteret e anëtarësimit), pika “1” (kriteret politike), nënpika”1.1.”(Demokracia dhe shteti i së drejtës), fq.10  
21[21] Vendimi nr.9/2010  
22[22] Dokumenti (COM(2010) 680), në pjesën “B” (kriteret e anëtarësimit), pika “1” (kriteret politike), nënpika”1.1.”(Demokracia dhe shteti i së drejtës), fq.10  
23[23] Vendimi nr.27/2010; Vendimi nr.43/2011  
24[24] Vendimi nr.24/ 2011  
25[25] *Ibid*, fq.7  
26[26] *Ibid*, fq.11  
27[27] Progres-Raporti i Komisionit Evropian 2011, fq.12
-

28[28] “ Opinion mbi Aplikimin e Shqipërisë për Anëtarësim në BE” (dokumenti {COM(2010) 680}), në pjesën “B” (Kriteret e anëtarësimit), pika “1” (Kriteret Politike), nënpika “1.1” (Demokracia dhe Shteti i së Drejtës), 9 nëntor 2010, faqja 9-10.

---